



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:103103
Datë: 12.06.2024
Numri i dokumentit: 05812722

K.DH.SH.II.nr.1131/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit padisë së paditësit "G.B. Construction" dhe "Ylli Pashtriku" sh.p.k. me seli në Gjakovë, përfaqësuar nga Korab Bokshi avokat nga Gjakova Rr. Tirana nr.40 kati i tretë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për anulim të vendimit të 01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024 me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses/ propozuesit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Cëshjte Administrative, KA.nr.166/24, të datës 22.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e paditësve-propozuesve padisë së paditësit "G.B. Construction" dhe "Ylli Pashtriku" sh.p.k. me seli në Gjakovë, ANULOHET Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Cëshjte Administrative, KA.nr.166/24, të datës 22.04.2024, dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe rivendosje, Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Cëshjte Administrative.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – për Cëshjte Administrative, KA.nr.166/24, të datës 22.04.2024, është hedhur poshtë padia dhe propozimi i paditësit G.B. Construction" dhe "Ylli Pashtriku" sh.p.k. me seli në Gjakovë me propozim për shtyrje të vendimit 01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024, si e papranueshme.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësja/propozuesja G.B. Construction" dhe "Ylli Pashtriku" sh.p.k. me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë ankesën e të paditurës ta aprovojë si të bazuar dhe aktvendimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Cëshjte Administrative, KA.nr.166/24, të datës 22.04.2024, ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

I padituri/kundërpropozuesi, nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të ankesës, shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 13 par. 6 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe Nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi - propozuesi, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për anulimin e vendimit me nr. 01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024, e së bashku me padi ka paraqitur edhe propozimin - kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të njëjtit, deri në vendimin përfundimtar gjyqësor.

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Cëshjte Administrative i Gjykatës Komerciale me aktvendimin e atakuar KA.nr.166/24, të datës 22.04.2024 e ka hedhur poshtë padinë dhe propozimin e paditësit G.B. Construction" dhe "Ylli Pashtriku" sh.p.k. me seli në Gjakovë me propozim për shtyrje të vendimit 01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024, si të papranueshme.

Gjykata e Shkallës së parë në arsyet e aktvendimit të ankimuar ka theksuar se paditësi nuk ka dëshmuar se ka interes juridik në vendimin e kundërshtuar me të cilën ka përfunduar procedura e ankandit publik nr. 01-96302-1251 datë 29.01.2024 për dhënien në shfrytëzim afat gjatë prej 99 vite të pronës së paluajtshme komunale me nr. të parcelës P-.... sepse i njëjti nuk ka marrë

pjesë në këtë procedurë, andaj edhe në kuptim të nenit 34 të LKA-së gjykata në shkallë të parë e ka hedhur padinë me vendim.

Kolegji i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm një konkludim të tillë të gjykatës së shkallës së parë ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret Gjykata në shkallë të parë nuk ka arsyetuar se pse ka vepruar sipas nenit 34 të LKA-së, gjegjësisht nuk ka arsyetuar faktin se pse me vendimin 01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024 palës paditëse i është shqyrtuar ankesa gjegjësisht ka pasur cilësin e palës në procedurë, dhe se pala paditëse ka paraqitur padi ndaj aktit përfundimtar në procedurë administrative dhe se sipas nenit 10 të LKA-së përcaktohet se "të drejtën për të nisur konflikt administrativ ka personi fizik dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin përfundimtar i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor"

Andaj, rezulton se, gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj, gabimisht dhe pa arsyetuar provat që gjinden në shkresat e lëndës se a janë prekur interesat e paditësve ose interesi i drejtëpërdrejtë i tyre ka konstatuar se paditësja nuk ka interes juridik në vendimin e kundërshtuar.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të propozueses- paditëses, në ankesë të cekura më lartë ndaj aktvendimit të shkallës së parë, kolegji vlerëson se të njëjtat janë të vërtetuara, të mjaftueshme dhe bindëse për tu aprovuar ankesa.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative në mënyrë jo të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe jo drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, kur ka konstatuar se paditësit nuk kanë interes juridik, andaj ankesa si e tillë aprovohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar priset dhe lënda kthehet ne rivendosje, ku gjykata e shkallës së parë ka për obligim te arsyetoj faktet ne te cilat mbështetë arsyetimin e vendimit, e në veçanti faktin se paditësit a kanë interes juridik në këtë çështje e pastaj nëse gjen se paditësit kanë interes në këtë çështje gjykata në shkallë të parë fillimisht të vlerësoi propozimin për shtyerje të ekzekutimit të vendimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën d) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1131/24, data 12.06.2024

Kryetarja e kolegjit-Saranda Bogaj Sheremeti,

d.v